



KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË KONTRATËS

Bashkëlidhur Form. Sig. Kontrates no.

Neni 1. "PËRCAKTIME TË PËRGJITHSHME"

Kompania e sigurimit "ALBSIG" sh.a. këtu e në vazhdim, do të quhet **Siguruesi**. I **Siguruari ose Kontraktuesi**, këtu e në vazhdim do të quhet subjekti fizik ose juridik, pjesmarrës në një tender prokurimi, i cili është shpallur fitues nga Autoriteti Prokurues, publik ose jo. **Përfituesi**, këtu e në vazhdim do të quhet, Autoritet Prokurues që organizon procesin e tenderimit.

Neni 2. "OBJEKTI I KONTRATËS"

Objekti i kësaj kontrate sigurimi është marrëdhënia e juridike në të cilën: **1)** Siguruesi garanton Përfituesin për përmbushjen e detyrimeve të kontratës së prokurimit të nënshkruar ndërmjet palëve në përputhje me dokumentat e tenderit; **2)** I Siguruari detyrohet t'i kthejë Siguruesit çdo vlerë monetare të paguar prej tij në rast të ekzekutimit të garancisë siç përcaktohet në Pikën 1, të këtij neni.

Neni 3. "VLEFSHMËRIA E KONTRATËS"

3.1 Vlefshmëria e kësaj kontrate sigurimi fillon datën e nënshkrimit të kontratës së prokurimit nga palët në përputhje me dokumentat e tenderit, ose ate te shenuar ne Formular dhe mbaron me zbatimin e plotë të saj, në ditën e lëshimit të Çertifikatës së Mbarimit të Punimeve nga Përfituesi, por ne çdo rast jo me vone se data e shenuar ne Formular per perfundimin e saj. Vlefshmëria e këtij sigurimi në lidhje me pikën 2 të Nenit 2 shtrihet deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve të të Siguarit ndaj

Siguruesit. **3.2** Formulari i sigurimit të Kontratës është i vlefshëm vetëm kur është i shoqëruar me këto Kushte të Përgjithshme të Sigurimit të Kontratës, mbi bazën e të cilës ajo është lëshuar, në të kundërt Formulari i Sigurimit të Kontratës është i pavlefshëm.

Neni 4. "SHUMA E SIGURIMIT OSE GARANCISË."

4.1 Shuma e sigurimit shënohet në formularin e sigurimit të kontratës dhe përbën nivelin maksimal të detyrimit të Siguruesit ndaj Përfituesit dhe të të Siguarit ndaj Siguruesit në rastin e parashikuar në Pikën 2 të Nenit 2, të kësaj Kontrate. **4.2** Çdo rritje e mundshme e shumës së sigurimit të përcaktuar në Formularin e Sigurimit të Kontratës do të bëhet me miratimin e Siguruesit, kundrejt paraqitjes së një kerkese për këtë shtesë nga Përfituesi. Në rast se Siguruesi miraton rritjen e shumës fillestare të sigurimit, i Siguruari duhet të paguajë primin shtesë përkatës dhe të pajiset me një formular të ri të sigurimit të kontratës.

Neni 5. "Primi i Sigurimit"

Pagesa e primit të sigurimit kryhet pranë Deges ose agjencise së Siguruesit ku lëshohet Polica e Sigurimit. Pagesa e primit konsiderohet e kryer në momentin e kalimit të vlerës së tij, në llogarine e Siguruesit.

Neni 6. "EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE."

6.1 Siguruesi paguan shumen e garantuar brenda 15 ditëve nga mbërritja e kërkeses me shkrim nga Përfituesi, me kusht që në

SIGURUESI

I SIGURUARI





shkresë të jetë përcaktuar mosrealizimi i detyrimit kontraktor dhe vlera përkatëse e këtij mosrealizimi. Kundrejt kërkesës së Siguruesit palët duhet të paraqesin një kopje të kontrates së prokurimit të nënshkruar prej tyre. Përfituesi duhet të njoftojë Siguruesin brenda 30 ditëve nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit (mos realizimit). Në rast mos respektimi të këtij afati Siguruesi ka të drejtë të vendosë për pagesën ose jo të shumes se garantuar. **6.2** I Siguruari është i detyruari dhe përgjegjësi kryesor për realizimin e kontratës së prokurimit të lidhur me Përfituesin. I Siguruari me marrjen e dokumentit të kryerjes së pagesës nga Siguruesi në favor të Përfituesit detyrohet të rimbursojë Siguruesin brenda 7 ditëve, për vlerën e pagesës së kryer. Për vonesen tej këtij afati i Siguruari do të paguaj një penalitet prej 0,1 % në ditë të shumës së papaguar, si dhe të çdo shume ligjore tjetër të shpenzuar për arketimin e detyrimit kryesor.

Neni 7. "ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE"

Në rast mosmarrëveshjes, kur ato nuk zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetente është gjykata e vendit ku është lëshuar polica e sigurimit.

SIGURUESI

I SIGURUARI

